



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRI**

**URDHËR**

**NR.66, datë 30.07.2021**

**PËR**

**CAKTIMIN E KOORDINATORIT SHTETËROR PËR REALIZIMIN  
E PROGRAMIT “JAM SHOIPTAR” TË GJUHËS DHE KULTURËS  
SHOIPE**

Në mbështetje të pikes 3 të nenit 102 të Kushtetutës, dhe të vendimit nr.585, datë 22.07.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën dhe të planit të veprimit 2021-2025”,

**URDHËROJ:**

1. Caktimin e zëvendësministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. Bora Muzhaqi, si koordinator shtetëror për ndjekjen, organizimin dhe raportimin e punës për realizimin e programit “Jam shqiptar” të gjuhës dhe kulturës shqipe, në bazë të memorandumit të nënshkruar për këtë qëllim ndërmjet institucioneve përgjegjëse në zbatim të masës 34, të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr. 585, datë 22.07.2020, të Këshillit të Ministrave.
2. Zëvendësministri për Arsimin, Sportin dhe Rininë autorizohet të koordinojë punën ndërinstucionale për ndjekjen dhe realizimin e programit “Jam shqiptar” të gjuhës dhe kulturës shqipe. Për realizimin dhe ecurinë e procesit, koordinatori të raportojë me shkrim, çdo tre muaj në mbledhjen e rradhës së Komitetit



Shtetëror të Diasporës.

3. Urdhri nr. 112, datë 30.08.2019, i Kryeministrit, “Për caktimin e koordinatorit shtetëror për realizimin e programit “Jam shqiptar” të gjuhës dhe kulturës shqipe”, i ndryshuar, shfuqizohet.
4. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**EDI RAMA**